



Shoqata e të Verbërve të Kosovës
Kosova Association of the Blind
Udruzenje Slepih Kosova

RAPORT NARRATIV I PUNËS SË SHVK-së
JANAR -DHJETOR 2023

© [2022] - [Shoqata e të Verbërve të Kosovës]

Të gjitha të drejtat të rezervuara

Përbledhje ekzekutive

Aktivitetet kryesore që Shoqata e të Verbërve të Kosovës i ka zhvilluar gjatë periudhës Janar –Dhjetor 2023, në fushën e avokimit, arsimit, shëndetësisë, mirëqenjes sociale dhe rehabilitimit për personat e verbër, gjithashtu edhe me aktivitete sportive e kulturore.

Periudha ka qenë e ngjeshur më një aktiv intensiv, duke lobuar vazhdimisht për zbatimin e legjislacionit, krijimin e kushteve për personat e verbër, përmirësimin e gjendjes dhe arritjen e përfitimeve që atyre ua njeh Ligji për personat e verbër dhe ligjet tjera.

Shoqata në këtë përpjekje të vazhdueshme ka mbështetjen e disa donatorëve, që na kanë qëndruar përkrah dhe kanë mundësuar që anëtarësia jonë të përfitojë dhe të përmirësojë kushtet e jetës dhe pavarësimin e vazhdueshëm. Përkushtimi në misionin tonë, puna e përgjegjshme, bashkëpunimi dhe krijimi i partneriteteve ka qenë e rëndësishme për SHVK-në edhe në këtë periudhë. Është një kohë kur edhe vet SHVK ka zgjeruar kapacitetet e saj, plotësuar me disa rregullore të rëndësishme në funksionimin e saj.

Ekipi për hartimin e projekteve ka adresuar projekte te donatorët duke garantuar financim për shoqatën në mënyrë që ajo të mund kryej detyrat e saj. Projektet e zbatuara në këtë periudhë kanë të bëjnë me rritjen e kapaciteteve të shoqatës dhe profesionalizimin e shërbimeve që ajo ofron në komunitet, mbrojtjen e të drejtave të personave të verbër, avokimi për zbatimin e ligjit lidhur me punësimin, pajisjen me mjete tiflo teknike dhe tiflo didaktike, pjesëmarrjen e personave të verbër në aktivitete kulturore, nxitja e krijimtarisë dhe njohja me trashëgiminë kulturore dhe multi etnike të Kosovës, ngritjen e kapaciteteve të kuadrit arsimor që punon me personat me aftësi të kufizuara, etj

Edukimi i personave të verbër dhe pjesëmarrja në aktivitete sportive, janë poashtu dy sektor të rëndësishëm në përfshirjen e personave të verbër, prandaj në dy nga artikujt në vazhdim janë paraqitur gjithë aktivitete e zhvilluara në këto dy fusha.

Ne jemi të kënaqur që këto arritje dhe angazhim tonin e kemi paraqitur në mënyrë të hollësishme dhe kronologjike tek ju. Kjo i shërben jo vetëm informimit, por edhe rritjes së transparencës së punës së shoqatës të të verbërve të Kosovës.

Në bashkëpunim me shoqatat që perfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara dhe ne bashkëpunim me zyrën për qeverisje të mire pranë zyres së kryeministrit (ZQM/ZK), kemi dhënë një kontribut për hartimin e Planit Strategjikë Qeveritar për PAK për vitet në vazhdim. Ndërsa rezultat i kënaqshëm për SHVK i viti 2023 është se MASHTI ka përfunduar procedurën e tenderimit për zhvillimin e sintësë vokale në gjuhën shqipe, arritja e objektivës kryesore të SHVK-së. Ndërsa arritje tjerët është se SHVK në bashkëpunim me MFTP dhe sekretarinë saj sakëtisht kemi arrit plotësim ndryshimin e Rregullores së Komisionit mediko social që personat e verbër të grupit të parë të mos bëhet vlerësim i vazhdueshëm. Gjithashtu edhe MASHTI për herë të

parë ka parapra mjete per vitin 2024, blerjen e pajisjeve tiflo teknike tiflo didaktike, për të filluar zbatimin e nënti 10 pika 3 e ligjit për të verbër.

Arritje e perbashkët e viti 2023, pas avokimit dhe lobimit të përbashkët me OPAK, Ministria e Financave Punës dhe Trasnfereve, bazuar në Ligjin për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara punëdhënësit obligohen që për çdo 50 të

punësuar, të punësojnë së paku 1 person me aftësi të kufizuara, punëdhënësit nga sektori publik, privat dhe organizatat jo-qeveritare të cilët nuk e përmbushin obligimin ligjor për punësimin e personave me aftësi të kufizuara obligohen që për nxitjen e punësimin të kësaj kategorie, të paguajnë kontribute mujore në lartësi të shumës së pagës minimale. Kontributet mujore paguhen në llogarinë e veçantë në Thesar.

Shërbimet e ofruara gjatë viti 2023

Shoqata e të Verbërve të Kosovës e cila ka shtrirje gjeografike në tërë Republikën e Kosovës me degët e saj Nderkomunale dhe Komunale, në kuader të implementimi të projekteve të ndryshme ka ofruar shërbime të nevojsham për komunitetin e saj në: Orientim e Mobilitet dhe shkathtësi Ditore, Shkrim lexim në Braille, Teknologji Informative Asisituese për të Verbër dhe shërbime psiko sociale. Ndërsa shërbime administrative sipas nevojave te paraqitur. Shërbimet janë ofruar ne të gjitha qendrate, pra përmes degeve tona, sipas kërkesave dhe nevojave të anëtarëve tanë.

Përmes grandidi institucional i mbështetur nga KCSF është mbajtur një garë në shkrim lexim në braille me 48 pjesëmarrës, ndërsa trajnime janë mbajtur përmes mbështetjes fillimisht nga MFTP e tani nga Ministria e Drjetësisë.

Shërbimet janë ofruar nga MFTP janra -prill, ne orientim e mobilitet, shkrim lexim ne brail dhe ofrimi i këshilave psiko slociale ku nëkëtë periudhe janë ofruar shërbime për xxx persona të verbër dhe me dëtmime në të parë.

Gjithashtu, edhe në vitin 2023, ka vazhduar masa 1.6 e cila përmes kësaj masë janë punësuar 2 me kontratë të rregullt.

Shërbimet kanë vazhduar edhe pas muajit prill me mbështetje të MD, ku janë mbajtur kampingje me rreth 120 përfitues në marrjen e shërbimeve.

Shërbimet jane te nevojshme dhe te domosdoshme ne te gjitha fushat, pasi qe këto shërbime përveç qe mundesojn pavarësimin e personave te verbër, jane edhe te mireseradhura ne fushën e socializimit te te verbërve.

BASHKËPUNIMET DHE PËRKRAHJE NGA DONATOR TE NDRYSHME TE VITI 2023

SHVK ka pasur bashkëpunime me shumë institucione të R.Kosovës në nivel qendrorë dhe lokal. Me Qeverinë e Republikës së Kosovës saktësisht me Zyren për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, me Kuvendin, Zyren e Presidencës me ministritë dhe me departamente të ndryshme. Bashkëpunim më i vecant ka qenë më departamentin e pensioneve pranë Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, me qëllim të ri funksionalizimit të komisioni shtetror mediko Social. Pra, kontakti i shpeshtë me zyrtarët adekuat edhe në departamentin e pensioneve por edhe me QKUK-në kemi marr hapa konkret që aplikuesit (persoant e verber) të marrin kompensimin me kohe dhe vlerësim me dinjitet.

Bashkëpunime ka pasur edhe me ministrin e arsimit, për realizimin e objektivës së SHVK-së e cila ka për qëllim krijimin dhe zhvillimin e Sintezës Vokale në Gjuhën Shqipe, e cila vec ka finalizuar hapat e tenderimit dhe është në proces për shpallje të kompanisë fituese për krijimin e sintezës.

Bashkëpunime ka pasur edhe me Qendren Burimore për Mësim dhe Këshillim Xheladin Deda, për mbështetjen e aktiviteteve që ka realizuar SHVK, me Federatën e Sporteve për të Verbër gjithashtu, për fuqizimin e federatës por edhe për krijimin e kushteve për sportistët e verbër.

Gjithashtu bashkëpunimi nuk ka munguar edhe me përfaqësuesit e organizatave të personave me aftësi të kufizuara, ku kemi qenë aplikues të projekteve të përbashkëta, hartimin e strategjisë qeveritare për PAK, bashkëpunime edhe me shoqata e vendeve ballknaike, bashkëpunim tjetër ka qenë edhe me Forumin Kosovar I Aftësisë së Kufizuar I cili është duke punuar në finalizimin e Ligjit Gjithpërfshirës.

Këtu kemi qenë aktivë pasi që ligji i personave të verbër do të inkorporohet ashtu sic është në ligjin gjithpërfshirës, kjo është një kujdes i vecant pasi që ligji i personave të verbër për SHVK-në është i rëndësishëm së vecant dhe mbrohet me fanatizëm,

Shvk është e hapur për bashkëpunime me të gjithë akteret pa dallim, me qëllim të përmirësimit të jetës në përgjithësi të komuniteti të të verbër.

AKTIVITETE E ZHVILLUARA GJATË VITI DHE TAKIME E VIZITA TË NDRYSHME, 2023

Në këtë periudhë shoqata e të verbërve të Kosovës ka pasur një aktivitet të ngjeshur në lobim, avokim dhe në përmirësimin e kushteve të jetës dhe pavarësimin të komunitetit të personave të verbër në Kosovë. Aktivitetet e shoqatës janë mbështetur nga projektet ekzistuese me donatorë si dhe aktivitete nga obligimet që dalin nga misioni i shoqatës.

Gjatë këtij viti kanë qenë në implementim disa projekte të mbështetura nga Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), Presidenca e Republikës së Kosovës, MKRS, MFTP, MD, Kosova 2.0, Komisioni Evropian në bashkëpunim me Handikos dhe ATRC.

Pasqyra e aktiviteteve;

- Për zbatimin e Ligjit për personat e verbër, saktësisht neni 10 pika 3 për sigurimin e pajisjeve tifloteknike dhe tiflo didaktike janë zhvilluar takime me zyrtaret e lartë të ministrive të linjës, janë bërë edhe kërkesa por deri me tani vetëm MASHTI, ka parapra mjetet për sigurimin e disa prej tyre për vitin 2024, nder ministrit e tjera ende nuk kanë ndërmarr ndonjë hap konkret.
- Për zhvillim të sintezës vokale me MASHTI kemi qenë në kontakt dhe tani është në proces për shpalljen e fituesit sipas rregullave të tenderimit për zhvillimin e sintezës vokale në gjuhën shqipe.
- Është përcjell edhe masa 1.6 e aftësisimit dhe praktike në punë për PAK nga MFTP, e cila ka rezultuar me punësim të qendrueshëm për dy persona të verbër dhe me shumë se 20 kanë kry praktikë të ndryshme për të qenë të gatshëm për punësim të qndrueshmë.
- 5 janar 2023- Me moton "Brailli është mundësi dhe jo imagjinatë", është mbajtur konferencë për shënimin e ditëve të brail-it. Gjatë kësaj konference është prezantuar një historik i shpikësit francez të Shkrimit të Brailit pedagogut Louis Braille. Në këtë konferencë ishin të pranishëm zyrtar të lartë qeveritar, përfaqësues të institucioneve shkollore, përfaqësues të organizatave të personave me aftësi të kufizuara dhe vet personat e verbër.
- 23 janar 2023 Kryetari i SHVK-së z. Daut Tishuki, ka zhvilluar një takim pune me sekretarin e përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Kosovës z. Arben Krasniqi, së bashku me drejtorin e zyrës për qeverisje të mirë z. Habit Hajredini me bashkëpunëtore. Në takim u diskutu për qasjen në informacion të personave të verbër.
- Shoqata e të Verbërve të Kosovës ka pasur disa takime me Ekspertin për hartimin e termave të referencës të sintezës vokale në gjuhën shqipe së bashku me zyrtaret nga MASHTI dhe QBMK Xheladin Deda.

- Me 6 shkurt 2023 eksperti ne zyret e SHVK-se ka prezantuar draftin final te termave te references ne prezencen e zyrtarve te SHVK-se, MASHTI, dhe QBMK Xheladin Deda. Drafti final do te pranohet nga MASHTI permes kompanise fituese per hartimin e termave te references per zhvillimin e sinthezes vokale.
- 02 shkurt 2023, ShVK ka promovuar librin “Pak dritë” nga 13 krijues me 35 krijime letrar ne prozë, poezi e tregime te ndryshme nga personat e verbër.
- Ne këtë promovim morën pjesë zyrtar të ndryshëm, persona te verbër dhe media. Ky aktivitet u mbështet nga MKRS në kuadër të projektit “Të Verbëritë, Kultura dhe Trashëgimia në Kosovë”.
- 6 shkurt 2023 takim me Zvn/Sekretarin e Pergjithshem te Ministrise se MFPT-se, z. Enis Spahiu dhe keshilltarin e tij z. Elmi Fazliu, se bashku me udheheqesit e organizatave te personave me aftesi te kufizuara, sot diskutuam per infrastrukturen ligjore te personave me aftesi te kufizuara. Gjithashtu nje nga diskutimet ishte edhe kerkesa jone per ri-shikim te rregullorese se komisionit shtetror mediko social per rivlersimin e personave te verber te kategorise se pare, ku z. Spahiu, tha se do te behet rishikimi i rregullorese ne fjale, per mos rivleresim te katekorise se pare te personave te verber. Takimet ne kete perberje do te jene mujore, dhe SHVK ne secilin takim do te jap komente dhe sygjerimet e saj ne secilen takim per pavaresim sa me te plote dhe integruar per personat e verber.
- 20 gusht 2023, Punëtori për plotësim ndryshimi e Rregullorja se Komisionit shtetëror mediko socila është mbajtur nga data 18 gusht deri me 20 gusht 2023, të cilën e ka kryesuar sekretari i Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve z. Enis Spahiu. Ndërsa pjesëmarrës kanë qenë zyrtare nga departamenti i pensioneve, nga departamenti ligjore, divizioni i komisioneve mjekësore dhe përfaqësues të organizatave me aftësi të kufizuara.
- Gjatë kësaj punëtorie janë bërë plotësim ndryshimi i rregullores në fjalë që personat e verbër nuk do të kenë më rivlerësim dhe si rezultat i mos vlerësimit nuk do të ketë as mendim konsular i cili është mënjanu nga rregullorja në fuqi, ku në të kaluarën ka paraqitë probleme dhe vështirësi për personat e verbër, pasi që ka pas rast kur kanë pritë me kohë të gjatë për rivlerësim dhe kanë mbetur pa kompensim edhe pse ato janë kompozuar me vone mirëpo jo ne kohen e duhur.

Pra, plotësim ndryshimi i kësaj rregullore i lehtëson personin e verbër që të marr kompensim pa u maltretuar nëpër komisione dhe marrinë e mendimeve konsulare.

Java e njeriut me shkop të bardhë 15-22 tetor 2023

Java ndërkombëtare e njeriut me shkop të bardhë në datat 15-22 tetor edhe këtë vit është shënuar me një aktivitetesh që janë mbajtur në Kosovë organizuar nga Shoqata e të verbërve të Kosovës me partnerët e saj nga Qeveria e Kosovës, shoqatat ndër komunale dhe komunale të të verbërve, Qendrën burimor për mësim dhe këshillim Xheladin Deda, Bibliotekën për të verbër në prishtinë, etj.

Aktiviteti kryesor u mbaj në Prishtinë ku Shoqata e të Verbërve të Kosovës në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit mbajti një konferencë kushtuar Javës Ndërkombëtare të Njeriut me Shkop të Bardhë.

Konferencën e udhëhoqi drejtori i ZQM/ZK z. Habit Hajredini, ndërsa në panel ishte z. Daut Tishuki, kryetar i SHVK-se, z. Halil Kurmehaj, këshilltar i zëvendës kryeministrit të parë, znj. Luljeta Kabashi, nga MASHTI, znj. Leonora Nikçi nga KFOR-i, z. Bujar Kadriu u.d i drejtorit ekzekutiv në FKAK, Xhavit Kastrati drejtori i QBMK Xheladin Deda Peje, z. Rinor Ymeri nga Federata e sporteve për të verbër, dhe zyrtare të tjerë të institucioneve, përfaqësues të organizatave të personave me aftësi të kufizuara, persona të verbër dhe media.

Gjatë kësaj konference kryetari z. Tishuki, fillimisht bëri një prezantim të rëndësisë së javës së shkopit të bardhë, dhe gjithashtu theksoi nevojat që kanë personat e verbër në përgjithësi, por edhe u bë thirrje për veprim nga ana e institucioneve për zbatueshmërinë e ligjit për personat e verbër, edhe pse ka pasur nisma të mira siç është sinteza vokale në gjuhën shqipe, e cila është në proces për zhvillim të saj. Tishuki ka bërë një përmbledhje të historisë së javës së shkopit të bardhë deri në ditët e sotme dhe rëndësinë që ka ajo.

Habit Hajredini drejtori Zyrën për Qeverisje të mirë pranë kryeministrit tha se angazhimi me SHVK ka qenë i vazhdueshëm në aktivitete për shumë fusha. Në radhë parë iu referua sintezës vokale si një projekt dhe arritje madhore. Qeveria është në fazën e hartimit të strategjisë për personat me aftësi të kufizuara, që do jetë një ndihmës në vjetët në vazhdim, kurse një tjetër proces është ai i miratimit të Konventës së personave me aftësi të kufizuara në Kushtetutën e Kosovës, që është në proces për t'u miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, që pritet të shtojë angazhimet e institucioneve në mbrojtën dhe garantimin e të drejtës së personave me aftësi të kufizuara në Kosovë.

Pas tyre kanë folur edhe znj. Luljeta kabashi për angazhimet që ka pasur Ministria e Arsimit, si një nga ministritë e angazhuara shumë gjatë viteve të fundit, z. Halil Kurmehaj nga zyra e zëvendës kryeministrit tregoi aspektet ligjore të ndryshimeve që po ndodhin në legjislacioni kosovar duke përmendur Ligjin për zyrtaret publik që sapo ka hyrë në fuqi i cili normon punësimin e PAK si dhe miratimin e një akti të brendshëm për procedurat e punësimit të personave me aftësi të kufizuara, duke cekur edhe mundësinë e kryerjes së praktikës profesionale në kryeministri për personat e verbër.

Javës Ndërkombëtare e Njeriut me Shkop të Bardhë këtë vit përkon edhe me 20 vjetorin e themelimit të Shoqatës së të verbërve të Kosovës. Me këtë rast SHVK ndau këto mirënjohje për:

- kryeministrin e Republikës së Kosovës z. Albin Kurti, për angazhim në shpalljen e Vitit 2022- Vit i Personave me Aftësi të Kufizuara, vetëdijesim, angazhim dhe hapa konkret për qasje të barabartë për të gjithë.
- ministren e arsimit znj. Arbërie Nagavci, për krijimin e mundësive konkrete drejt zhvillimit të sintezës vokale në gjuhën shqipe
- mjeken Anita Mulolli Vrajolli, për kontributin e dhënë në vlerësimin e personave të verbër përmes Komisionit shtetëror mediko social
- Ejup Rashica, aktivist i dalluar i Shoqatës
- Enver Ulaj, për angazhim në aktivitete dhe fuqizimin e Shoqatës së të Verbërve të Kosovës
- Emine Prekaj Kuqi, për kontributin e dhënë në përmirësimin e jetës së personave të verbër në Kosovë

Ndërsa një mirënjohje post mort për aktivistin e ndjere Mexhit Foniqin, për kontributin e dhënë me vitet të tëra për personat e verbër.

Gjithashtu aktivitete janë shënuar edhe nepër degët e SHVK-së të cilat kaën shënuar aktivitete të ndryshme për nder të javës

Pjesëmarrja në festivalin ballkanik të të verbërve në Turqi

- 11-14 nëntor 2023 Shoqata e të Verbërve të Kosovës me ftesë nga Federata e të Verbërve të Turqisë, dhe me mbështetje të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit ka qenë pjesëmarrëse në festivalin ballkanik të të verbërve me një përfaqësim shumë profesional, me këngëtar dhe me instrumentistë në Kirklareli të Turqisë. Pjesëmarrës nga Kosova janë këngëtarë të zhanreve të ndryshme të këngës shqipe. Festivali është mbajtur për 5 ditë radhazi dhe ka qenë në qytete të ndryshme të Turqisë. Me veshja kombëtare dhe çiftelia simbolet tona kombëtare, janë prezantuar në secilin qytet të Turqisë nga këngëtarët tanë nga Kosova. Kjo është pjesëmarrja e dytë e artistëve të verbër nga Kosova në Turqi. Vitin e kaluar artistët kanë marrë pjesë në festivalin në Çanakkala të Turqisë.

Me Ministrinë e financave diskutohet rimbursimi i energjisë elektrike për personat e verbër

- Një takim i përbashkët me drejtorin e ri të Departamentit të pensioneve z. Blerim Hasani dhe bashkëpunëtorin tonë shumëvjeçarë z. Skënder Asllani. Në takim u diskutuan shumë tema, e ndër to ishte edhe mundësia për rimbursim për energji elektrike për personat e verbër bazuar në të drejtën ligjore dhe punimi i librezave të verbërisë për vitin 2024 e tutje. Për çështjen e rimbursim të energjisë elektrike për personat e verbër, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, ka ofruar një platformë për aplikim, mirëpo ka qenë shumë konfuze aplikimi pasi që nuk është rregulluar mirë mënyra e aplikimit për personat e verbër apo edhe të kategorive të personave të tjerë, mirëpo përveç kësaj ka qenë edhe e vështirë aplikimit për disa të qytetar të zonave më të thella. Dhe në këtë kontekst na është kërkuar një listë e atyre personave të verbër të cilët nuk kanë aplikuar në platformë në mënyrë që ky departament ta shqyrtojë mundësinë e rimbursimit të energjisë elektrike e drejtë e garantuar me ligj. Ndërsa, librezat e verbërisë për anëtarësinë që gëzon një nga dy kategoritë e verbërisë që i njëh ligji në Kosovë do të jenë të gatshme dhe, sipas drejtorit të departamentit, ato do fillojnë të shpërndahen nga 1 janari i viti 2024.

Konferenca kushtuar ditës ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

- Në konferencën kushtuar ditës ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, e cila u mbajt në prezencën e zyrtarëve të lartë institucional paraqitëm kërkesën bazë të Shoqatës së të Verbërve të Kosovës, që është zbatueshmëria e ligjit për personat e verbër. Gjithashtu, theksuam vështirësitë të cilat i kanë hasur personat e verbër në aplikimin e platformës për subvencionimin e benifiteve të energjisë elektrike, ndërsa falënderuam MASHTI-n për përpjekjet për nismat konkrete për krijimin e sintezës vokale në gjuhën shqipe dhe fillimin për herë të parë të zbatueshmërinë se neni 10 pika 3 e ligjit për personat e verbër. Zyrtarët institucionalë kanë premtuar dhe kanë shpreh gatishmëri për zbatueshmërinë ligjore për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.

- **Dhjetori**

Në zyrat e SHVK së pritem në takim kontingjentin e KFOR-IT italian në Kosovë LMT K8, i përfaqësuar nga GRD.A Cacioppo Lucio me bashkëpunëtorë Lulianella Mauro, Andrea Zizzari, Giovanni Veccnarini dhe Luan Bogaj. Në takim kryetari z. Daut Tishuki, njoftoj përfaqësuesit e KFOR- it Italian për sfidat që ka shoqata, por gjithsesi edhe për rezultatet e saj falë punës dhe bashkëpunimit me te gjithë akteret e ndryshëm te shoqatës. Gjithashtu, u diskutua edhe për mundësit e bashkëpunimit ne mes te KFOR-it Italian ne Kosovës dhe Shoqatës së të Verbërve të Kosovës.

Iniciativa për themelimin e qendrës për studentët me nevoja të veçanta në UP

5 dhjetor 2023

Universiteti i Prishtinës ka ndërmarrë iniciativën për themelimin e qendrës për studentët me nevoja të veçanta.

Qëllimi i qendrës është të ofrojë shërbime mbështetëse të përshtatura për studentët me nevoja të veçanta për të lehtësuar përvojën universitare dhe për të nxitur një përvojë arsimore gjithëpërfshirëse.

Në një takim të përbashkët në objektin e rektoratit, rektori z. Qerimi, prorektorja prof. Llulaku, zëvendëskryeministri i parë z. Beslim Bislimin, z. Nuno Queiros, përfaqësues i përhershëm i UNDP në Kosovë, Forumin Kosovar për Aftësinë e Kufizuar, si dhe profesorë dhe studentë, u theksua rëndësia e krijimit të qendrës dhe ofrimin e shanseve të barabarta për të gjithë.

Kjo nismë qëndron si një dëshmi e përkushtimit të rektoratit ndaj gjithë përfshirjes, diversitetit dhe ofrimit të mundësive të barabarta për të gjithë studentët. Krijimi i kësaj qendre simbolizon përkushtimin e rektoratit për të krijuar një mjedis ku çdo individ, pavarësisht aftësive apo sfidave të tij apo saj, të ketë qasje të barabartë në arsim cilësor dhe mundësi për rritje dhe sukses personal.

Qendra do përfshijë infrastrukturën dhe pajisjet e nevojshme për studentët si dhe në kuadër të qendrës do jenë pikë kontakti zyrtaret për shërbime të studentëve nga çdo njësi akademike të cilët kanë kaluar në trajnimin adekuat.

Kjo iniciativë mbështetet nga UNDP në Kosovë, të cilët i falënderojmë së bashku me gjithë partnerët vendor për mbështetjen.

Nënkryetarja e SHVK merr çmimin “Hyjnesha e shtetit”

8 dhjetor 2023

Në Sëiss Diamond u mbajt ceremonia festive për nder të 10 dhjetorit Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, organizuar nga Ambasadorja e Vullnetit të Mirë në Kosovës znj. Elvana Shala. Në këtë ngjarje ishim të ftuar si SHVK por edhe kishim të nominuar anëtarin tonë për marrjen e çmimit “Hyjneshat e shtetit”.

Felona Bajrami e nominuar nga Shoqata e të Verbërve të Kosovës, është nderuar me titullin "Hyjnesha e Shtetit " për angazhim dhe përkushtimin e saj për komunitetin e të verbërve.

Të nderuara me titullin "Hyjnesha e Shtetit" në një ceremoni solemne janë nderuar 33 gra e vajza, që kanë dhënë kontribut në përmirësimin e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës Çmimi ju nda nga Ambasadorja e Vullnetit të mirë znj. Elvana Shala.

Donacion nga kompania Webhelp

20 dhjetor 2023

Kompania Eëbhelp ka ndarë për SHVK-në 3000€ donacion për aktivitet e saj.

Te pranishëm në zyret e SHVK-se për dhurimin e këtij donacioni ishin Michael Kaindl dhe Edon Guraziu. Shoqata e të Verbërve të Kosovës për nder të Javës Ndërkombëtare të Njeriut me Shkop te Bardhë ka nda mirënjohje për këtë kompani e cili tashmë e ka bërë tradicionale donacionin ku në këtë vite është dyfishua shuma e donacionit

SHVK falënderon për këtë kontribute kompaninë webhelp

Shoqata ka implemtuar edhe disa projekte te vogal dhe në fund të muajit dhjetor ka nënshkrua kontrata bashkëpunimi për vitin 2023:

Vazhdimesi e projektit te KCSF dhe MKRS

Nje perkrahje tjeter ka qene nga Presidenca e Republikes se Kosoves per shtypjen ne shkrimin braille te revistes “syri yne”.

Ministria e Drejtësisë per ofrimin e shërbimeve specifike per personat e verber

ATRC ne fushën e avokimit per krijimin e mundësive per punësim te personave te verbër

Kosova 2.0 e cila eshte ende duke vazhduar ne shtypjen e revistës SYRI YNE, ku te gjitha numrat jane publikuar ne web faqen tone dhe ne fanpagen e shoqates

Paraqitja ne media

Kryetari z. Tishuki, një intervistë për KTV-në, ka kërkuar zbatueshmërinë e Ligjit për Aftësim, Ri aftësim Profesional dhe Punësim të Personave me Aftësi të Kufizuar, e konkretisht për zbatueshmërinë e nenit në kuadër të ligjit për personat e verbër, i cili obligonë ministrinë e linjës për sigurimin e paisjeve tifo teknike dhe tifo didaktike, duke e çmuar donacionin e dhuruar nga Ambasada Çeke vite me radhë.

Ka pasur edhe paraqitje dhe reagime të ndryshme për mbrojtje të komuniteti të verbërve në Republikën e Kosovës në mediat lokale dhe në ato të shkruara.

Ju lutem për zhvillimin e aktiviteteve gjëni linkun e faqes së SHVK ku çdo aktivitet është i publikuar:

Linku: <https://ëëë.facebook.com/profile.php?id=100064254836742>

<https://ëëë.facebook.com/rtklivecom/videos/1578780382634210>

Rekomandimet për vitin 2024:

- 1. Ngritja e kapaciteteve të SHVK-së në burime njerzore për ofrimin e shërbimeve sa më profesionale të personave të verbër dhe me dëmtime në të parë**
- 2. Krijimi i kushteve për personat e verbër, bazuar në legjislacionin aktual, edukim, shëndetësi, rehabilitim dhe punësim.**
- 3. Krijimi i qendrese rehabilituese për personat e verbër**